VENDIM
Nr.38, datë 18.5.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË KODIN E FUNKSIONIMIT TË RRJETIT (KODI I TRANSMETIMIT)

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të nenit 26 pika 2 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.5.2009, pasi shqyrtoi dhe analizoi propozimin e Komisionit të Rishikimit të Kodit të Funksionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), të cilat do të mundësojnë përdorimin e njësive gjeneruese të parregullueshme në disa HEC-eve të reja,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Funksionimit të Rrjetit (Kodi i Transmetimit), i miratuar me vendimin nr.123, datë 24.10.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s. (Ndryshimet bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta